



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Gllogocit Burim Bujupi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit	
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 04.09.2026 -VI-020-570
Zyrtarët përgjegjës:	Erbilin Hetemi , Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Diturie Bekteshi , Zytare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 8, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, marrë parasysh se ky vendim nuk bënë pjesë të vendimet e përgjithshme të kuvendit të komunës vlerëson se:

- Vendimi 02Nr.020/04-37193 për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gllogocit, i miratuar me datë 31.08.2026 në Kuvendin e Komunës së Gllogocit, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gilogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 020/04-37/193 dat. 30/08/2026

HYRËSE - ULAZNA - ПРИЛОЖЕНИЕ		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data Datum Date:	01.09.2026	
Hësia organizatike	Nr. i Lartësimit	Vlera
-VI- 020-570		



Bazuar në nenin 11, 12, 40 Ligjit Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8 dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2026 miratoi këtë:

V e n d i m

Për Themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit.

Neni 1

Më këtë Vendim Kuvendi i Komunës miratoi themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit në këtë përbërje:

1. Ruzhdi Lestrani-Kryesues;
2. Altina Mulaj Ilajdini-Anëtarë;
3. Valdet Curri-Anëtarë;
4. Driton Ajazi-Anëtarë;
5. Arbër Ilalilaj-Anëtarë;

Neni 2

Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit ka për detyrë që të shqyrtojë Statutin aktual të Komunës së Drenasit, të identifikojë dispozitat të cilat kanë nevojë për ndryshimin dhe/ose plotësim, të propozojë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojë me strukturat dhe njësitë përkatëse të Komunës gjatë hartimit të ndryshimeve dhe plotësimeve, si dhe të përgatisë drafstatutin për ndryshimin dhe/ose ndryshimin e Statutit të Komunës dhe ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës së Drenasit.

Neni 3

Mandati i Komisionit fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi dhe përfundon me përmbylljen e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

Neni 4

Komisioni, pas përfundimit të punës, i paraqet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës draftin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit, së bashku me arsyetimin përkatës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

A R S Y E T I M

Komuna e Drenasit me qëllim të shqyrtimit dhe harmonizimit të Statutit të Komunës së Drenasit me legjislationin në fuqi dhe nevojat e funksionimit të Komunës, Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

Komisioni do të shqyrtojë dispozitat ekzistuese dhe do të përgatisë propozimet përkatëse për ndryshime dhe plotësime, të cilat do ti procedojë për shqyrtim dhe miratim nga organet kompetente, andaj për këtë arsye, propozohet miratimi i këtij propozim vendimi.